

Dorëshkrim i panjohur i Eqrem bej Vlorës

“Historia e sundimit turk në Shqipëri”

U zbulua dorëshkrimi i veprës kryesore të Eqrem bej Vlorës: Kjo vepër monumentale është historia e Shqipërisë nga koha e pushtimit osman deri në kohën e pavarësisë.

Robert Elsie

Eqrem bej Vlora (1885-1964) ka lindur në Vlorë në një familje çifligare të njohur të jugut të Shqipërisë. U arsimua në shkollën Terezianum në Vjenë më 1899-1903, dhe studioi për drejtësi dhe fenë islame në Stamboll në vitin 1904. Punoi për një kohë të caktuar për qeverinë osmane, kur më 1907 kaloi edhe tre muaj në ambasadën osmane në Shën Petersburg. Udhëtoi shumë në Evropë, në Shqipëri dhe në Lindjen e Mesme para se të bashkohej me kushëririn e babait të tij, Ismail Qemal bej Vlora (1844-1919), në lëvizjen për pavarësinë e Shqipërisë.

Në vitin 1912 u emërua zëvendëskryetari i senatit shqiptar. Gjatë Luftës së Parë Botërore u burgos në Itali, por më vonë u bë përkrahës i marrëdhënieve të ngushta midis Shqipërisë dhe Italisë. Në vitin 1924 u zgjodh deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ku përfaqësoi në radhë të parë interesat e klasës së tij, dhe në vitin 1925 u emërua senator. Marrëdhëniet e tij me Ahmet Zogun ishin të tendosura. Megjithatë, Eqrem beu i shërbeu Zogut në disa misione diplomatike jashtë vendit. Ai ishte mik i ngushtë i baroneshës gjermane, Mari Ameli Fon Godin (1882-1956), një autore bavareze me një prirje të theksuar për Shqipërinë, e cila ka përkthyer në gjermanisht Kanunin e Lekë Dukagjinit. Siç thuhet, ata nuk u martuan për shkak të fesë. Ajo si besimtare katolike nuk mund të martohej me një mylisman.

Eqrem beu e mirëpriti pushtimin italian të Shqipërisë në prill të vitit 1939 dhe kishte marrëdhënie të mira me fashistët italianë. Në vitin 1942, Mustafa Kruja (1887-1958) e emëroi ministër për Kosovën, e cila më në fund u ribashkua me Shqipërinë amë. Politika e tij antisllave i mundoi shumë serbët dhe malazezët e Kosovës. Në verë të vitit 1944 u emërua ministër i punëve të jashtme dhe ministër i drejtësisë, por me ardhjen në pushtet të parti-

zanëve komunistë në nëntor të atij viti, Eqrem beu iku në Romë, ku vdiq me 29 mars 1964.

Si autor, Eqrem bej Vlora njihet për monografinë e tij *Aus Berat und vom Tomor: Tagebuchblätter*, Sarajevu 1911 (shqip *Nga Berati në Tomorr dhe kthim*, Tiranë 2003), dhe në veçanti, për kujtimet e tij të bukura, *Lebenserinnerungen*, Mynih 1968-1973, botuar tani edhe shqip, në përkthimin mjeshtëror të Afrim Koçit, *Kujtime*, Tiranë 2002, edhe turqisht, *Osmanli Arnavutluk'undan anılar (1885-1912)*, Stamboll 2006.

Megjithatë, vepra kryesore e Eqrem bej Vlorës ka mbetur në hije deri tani. Ajo njihet vetëm nga një grusht njerëzish. Është fjala për një dorëshkrim gjermanisht me jo më pak se 1200 faqe, me titullin *Beiträge zur Ge-*

schichte der Türkenherrschaft in Albanien: eine historische Skizze (Kontribute për historinë e sundimit turk në Shqipëri: një skicë historike). Kjo vepër monumentale është historia e Shqipërisë nga koha e pushtimit osman deri në kohën e pavarësisë. Ajo u hartua, në bashkautorësi me baroneshën Fon Godin, në Romë në vitet 1955-1956, kur Eqrem beu jetonte në mërgim.

Në atë kohë, Eqrem beu ishte shtatëdhjetëvjeçar dhe hartoi dorëshkrimin e gjatë kryesisht nga kujtesa e tij. Bibliotekën e tij të madhe nuk e kishte më në dispozicion. Në vitin 1944, ajo ishte bërë gati - e paketuar në disa kuti prej druri - për transport në Itali, por në trazirat e kohës, ajo mbeti në Shqipëri. Nuk dihet fati i kësaj biblioteke, e cila ka të ngjarë të ketë patur shumë dorëshkrime të vlefshme osmane. Siç duket, ajo nuk gjendet në fondet e Bibliotekës Kombëtare të Tiranës.

Mikja shumëvjeçare e Eqrem beut, Mari Ameli Fon Godin, vdiq më 22 shkurt 1956 gjatë kohës së përfundimit të dorëshkrimit, kështu që projekti i madh për botimin e librit në Gjermani mbeti i perealizuar. Ju shprehim mirënjohjen Afife dhe Tanush Frashrit në Austri, të cilët kanë ruajtur këtë dorëshkrim historik. Nëse ky dorëshkrim do të botohet ndonjë ditë, historia e Shqipërisë në kohën osmane do të kuptohet më mirë.

Këtu, për herë të parë, botohet shqip një fragment i dorëshkrimit të Eqrem beut *Kontribute për historinë e sundimit turk në Shqipëri*. Është fjala për parathënien e veprës ku autori e prezanton “skicën” e tij 1200 faqëshe.



Eqrem Vlora (majtas) me Avni Delvinën në Grac, Austri

Sundimi turk në Shqipëri

(Një skicë historike)

Parafjalë e Eqrem bej Vlorës

Kur më 1912 nisën luftërat e shteteve të Ballkanit kundër Turqisë, gjë që për ata që nuk merrnin fort erë në punërat e gadishullit erdhi si beftë, të dy shkruesit gjendeshin në Vlorë, në konak të Beut të Vlorës. Pasi porti i Vlorës u mbyll papritur, ndërkohë që nga Durrësi po venevinin anijet austriake, të dy morën udhë për atje, sepse baronesha Godin kishte parapëlqyer të ikte për Gjermani para se të goditej nga ndonjë gjëmë e turbullirave.

“Po udhëtonim kalorësisht në një karrocë hungareze të gjuetisë gjithë rrotë, nga ato që quhen ‘wurst’, dhe ishim në përcjellje të dhjetë kalorësve të armatosur vlonjatë. Nuk po çanim përmes udhësh, por Myzeqesë së mbytur në shirat vjeshtake, lëviznim nëpër gjurmë qerresh, të padikutueshëm dhe krejtësisht të sigurt, derisa syve të huaj që rrallë na bëheshin ndër ato shtigje do të mund t’u jemi dukur sikur po iknim nga ndonjë luftë.

Qemal bej Vrioni, bashkë me nja njëzet burra të tij po na priste afër Vjosës. U ulëm përreth një zjarri të madh ndanë bregut për të ngrënë një drekë me ushqime gjithfare: pjekurina mishi, byrek e fruta.

Kur kishim mbaruar së ngrëni, njëri nga burrat e Qemal beut u ngrit dhe thirri me gëzim: ‘Rroftë Beu ynë, prijësi ynë i mençur!’ Në mbremje arritëm Kullat e Fierit, selinë e beut Vrioni. Në mes të parkut, jo më shumë se një të hedhur guri larg nga shtëpitë e familjes, gjendej një pavijon në të cilin kishin përgatitur darkën rreth dyzetë veta. Aty, në praninë e Ymer Pashës dhe Galip Pashë Vrionit, drekonte secili që ishte i nderuar në vend dhe kthente në tregun e Fierit, - kjo mikpritje e paimagjinueshme për të huajt u kushtonte



atyre gjysmën e të hyrave nga 30 000 ha tokë sa kishin.

Në ndërkohë ishte bllokuar edhe porti i Durrësit dhe ne kishim vendosur të ktheheshim në Vlorë. Por, nga shirat e pambarim Vjosa ishte ënjtur aq shumë sa anija nuk arriti të na kalonte matanë lumit dhe ne s’na mbeti tjetër veçse të bunim në shtëpinë e varkëtarit, të gjithë në një dhomë. Në fillim autorja thau afër oxhakut të gjitha rrobat e saj, pastaj këtë e bënë burrat, dhe në fund u ngjallëm pak me raki dhe djathë delesh. Pastaj u mbështollëm me mantelet tona dhe fjetëm të lumtur që kishim një kulm mbi kokë. Vetëm gjatë pasdites së nesërme arritëm ta kalojmë rrjedhën e zbutur të lumit.

Në ndërkohë, në jug të vendit, në regjionin e Himarës, kishin rënë grekët, ndërsa veriun e vendit e kishin vërshuar serbët. Një mëngjesi në Kuvendin e Vlorës ishte ngritur Ekrem bej Vlora dhe kishte thirrur: ‘Unë po nisem në luftë kundër grekërve, kush vie pas meje?’ E kishin pasuar disa qindra veta, shumica nga farefisnia e tij.

Pak kohë më vonë, në një Kuvend Kombëtar, në të cilin, të përcjellë nga pasues të armatosur, morën pjesë pasanikë, fisnikë e patriotë nga të

gjitha anët e vendit, u shpall në Vlorë Pavarësia e Shqipërisë. Erdhën aty bejtë e Vlorës, pastaj Vrionët, Libohovët, Frashriotët, fisniku Abdi bej Toptani, Patër Gjergj Fishta e don Kaçorri, bejtë nga Gjakova dhe Dibra, nga Kosova Isa Boletini me të dymbëdhjetë bijtë e vet, pastaj bejlerët e agallarët nga Labëria dhe bejlerët Selimaj-Dosti nga Delvina, Dervish bej Biçaku nga Elbasani me pinjollin Ahmet Zogu nga Mati dhe shumë, shumë të tjerë.

Ismail Qemal bej Vlora kryesonte Kuvendin.

Këto detaje do të duhej të ofronin një pasqyrë nga Shqipëria e asaj kohe, e cila edhe ashtu ishte e zhytur në një gjendje mesjete. Fillimisht u bashkuan, por ndonja dhjetë vjet më vonë Hamid bej Toptani me prijësit e Dibres mblodhën përmbi 5000 veta që t’i kundërviheshin pretendentit Ahmet bej Zogu, me arsyetimin se veç të barabartët do të kishin të drejtën të konkurronin. Njësoj kishin vepruar edhe Serreçët dhe fisnikët tjerë katolikë në Veri, të cilët kishin mbledhur një ushtri të vogël për të njëjtin qëllim. Por, le të përmendim kalimthi, se Ahmet Zogu, ai që më vonë do të bëhej mbret, u tregua shumë i zgjuar dhe i aftë që, para se të shkrepej as edhe një plumb, arriti t’i bindte përfaqësuesit tjerë se planet e tija ishin më të mirat për Shqipërinë.

Nën Mbretin Zog Shqipëria arriti me një shpejtësi habitëse t’u përshtatej kushteve europiane; u ndërtauan rrugë, ura, shkolla, në të gjithë vendin u vendos një ligj modern. Ajo që po ndodh me këtë vend tani, nën sundimin komunist, zgjon nevojën që ndodhitë e njohura nga e kaluara t’i dokumentojmë për të ardhmen, sepse Shqipëria edhe njëherë po i nënshtrohet një epoke të panjohur për të.

Derisa para njëzet vjetësh edhe më i thjeshti prijës shqiptar kishte njohuri për të kaluarën e vendit dhe

të fisit të tij, gjenerata e re as që vret mendjen për këto gjëra, madje, aq më shumë, ajo bën ç'është e mundur që, siç e quajnë vetë, 'të kaluarës së errët' t'i vejë pikë. Shumë më i shprehur se në pjesë tjera të Europës shfaqet tani atje refuzimi për patriarkalizmin, si një rrugë e gabueshme, madje as vlerat e traditës shtëpiake nuk kultivohen më. Kështu që s'kemi si të mos brengosemi se gjithçka do të mund të përpihej nga harrimi nëse ne, si të fundmit dëshmitarë me sy e veshë, nuk mundohemi t'i dokumentojmë këto gjëra."

Vendosmëria jonë për të dëshmuar krejt çka dimë për kohën e Shqipërisë nën sundimin turk (se shekujt e para kësaj kohe veç janë dëshmuar në mënyrë kompetente) është përforcuar edhe më nga testamenti i Gjon Muzakës. Gjoni kishte shkruar këto kujtime me gjasë rreth vitit 1510, pas ikjes së tij nga Durrësi për në Itali, dhe i kishte dedikuar për fëmijët dhe pasardhësit e vet. Në to ai kishte pasqyruar për ta gjerësisht pushtimin e shtëpisë së tij dhe të të afërmeve të tij si dhe gjendjen e përgjithshme në vend gjatë asaj kohe. Ai kishte përmyllur shkrimet e tija me ca anëshkrime, të cilat të bëjnë të kuptosh se ai do të kishte dëshirë dhe qëllim që të shkruante edhe më shumë dhe më hollësisht, pa pasur dert se do të mund t'i bëhej i tepërt lexuesit me gjithë ato ekzagjerime dhe përshkrime të parëndësishme.

Mu ato për të cilat ai mendonte se ishin të parëndësishme, me gjasë do të mund të shpërfaqnin si asgjë tjetër vërtetësinë e asaj kohe. Për këtë arsye do të kemi kujdes e të mos bëjmë të njëjtat gabime, ne, thënë shkurt, do të bëjmë çmos që t'i përshkruajmë sa më mirë dhe me plotëni që

është e mundur të gjitha ndodhitë, si në një skicë dhe jemi të bindur se mu përmes këtij procesi do të mund t'i ndihmojmë ardhmërisë së shkencës.

2. Gjithë ajo që i shpëton harrimit është një fitore e përbashkët e njerëzimit

Fusha të cilën duamë ta studiojmë deri më sot ka qenë e paprekur. Ne po nisemi në këtë mision të vetëdijshëm se nuk do të mund ta paraqesim tërësisht dhe pa zbrazëti- ra eventuale gjithë këtë histori, por



Mbreti i shqiptarëve, Zogu I

marrim guxim nga e thëna se gjithë ajo që i shpëton harrimit është një fitore e përbashkët e njerëzimit.

Në gjithë makthin e shënimeve turke nuk është aspak lehtë të gjendet një shteg i duhur, andaj qëllimi ynë mund të ketë vetëm atëherë sukses, kur do t'i kemi analizuar dhe sistematizuar të gjitha burimet dhe lajmet, duke krijuar kështu një konstrukt të fortë në të cilin pastaj do të mund t'i ngjishnim hollësitë.

Ta injorosh rëndësinë e kohës së sundimit turk në Shqipëri është marrëzi, sepse populli shqiptar (siç qe gjer më 1912 dhe është tash kur ikja e turqve sa s'ka ndodhur) është në të shumtë prodhim i asaj kohe. As sundimi bizantin dhe as ai serbo-bullgar nuk kanë lënë gjurmë më të thella në këtë vend dhe në këtë popull.

Me gjithë ngjashmëritë e padiskutueshme të popullit shqiptar me botëkuptimet, doket dhe zakonet e fqinjëve të vet, edhe në rastin e tij u

pa se bashkëjetesa dhe bashkëpunimi i dy popujve nuk mund të kalojë pa një ndikim reciprok. Është e vërtetë se popullsia e veriut apo e jugut të Shqipërisë nuk u është përmbajtur rregullave religjioze apo sociale të imponuara nga turqit, por megjithatë edhe atje ka pasur një afrim në qëndrimet dhe në institucionet e Perandorisë Osmane dhe asnjëri nuk e vë në dyshim se gjatë këtyre pesë shekujve Populli shqiptar kontribuoi në rritjen e Perandorisë, se ai pa hezitim gëzoi përparësitë që iu ofruan dhe se kontributi e vullneti i tij janë shpërblyer nga Perandoria.

Në fillim pushtimin turk e kanë kundërshtuar para së gjithash shtresat e larta shqiptare, por masat e gjëra popullore e kanë pranuar pa asnjë dyshim ardhjen e osmanëve sikur një çlirim nga sundimi sllav.

Mjafton t'i shikojmë ligjet sociale të Nemanjiçëve dhe të bindemi rreth kësaj (Kodin e Stefan Dushanit). Përmes tyre (1189-1389) shqiptarët si dhe arumunët janë mbajtur në një gjendje gjysmë skllavërie dhe shfrytëzoheshin nga sundues serbë, nga manastiret serbe, si dhe nga bashkëpunëtorët dhe përkrahësit e tyre shqiptarë. Ky vlerësim vërtetohet nga zhvillimet e padiskutueshme të popullit shqiptar gjatë ven-

dosjes së sundimit turk, me ç' rast ai në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në Greqi arriti të bëhet popullsi shumicë. Për konvertimin në fenë Islame Perandoria ofronte të drejta të barabarta me sunduesit e rinj.

Sot, kur koha ka zvogëluar hidhësinë e ndjenjave, të cilat para përfundimit të sundimit turk qenë zgjuar në formë ankesash nacionale e religjioze dhe që çuan në kryengritje, nuk kemi si të mos pranojmë se turqit edhe atyre pakicave që nuk u nënshtroheshin sistemit teokratik të tyre u dhanë njëfarë autonomie në jetë. Mëshira turke u bënte të mundur një numri të pafund shqiptarësh të merrnin pjesë aktive në administratën dhe ushtrinë e Perandorisë. Kjo s'paraqiste ndonjë risi, sepse edhe në Perandorinë Romake, edhe

gjatë sundimit të Bizantit, të Serbëve, Bullgarëve, Napolitanëve, por edhe të Republikës së Venedikut, shqiptarët gjithnjë kanë marrë pjesë aktive në administratë dhe në udhëheqje të ushtrisë dhe kishin mundësi, me kusht që të kishin hequr më parë dorë nga kundërshtia ndaj sunduesve të rinj, të tregonin aftësitë e tyre të shkëlqyeshme në udhëheqje.

Sa u përket marrëdhënieve të shqiptarëve me turqit, duhet të theksohet se që në vazhden e shekullit 15. administrata dhe komandoja ushtarake otomane në Shqipëri ishte dorëzuar në duar të shqiptarëve. P.sh. këtë e vërteton kronisti turk Ahmed Dervish Pasha: "Treva shqiptare shtrihej larg qendrës administrative (Konstantinopolit), vendi ishte i varfër dhe i pashpresë, banohej nga një popullsi trime, luftarake. Për të evituar rrezikun që Shqipëria të shndërrohej në një zonë të përhershme trazirash, Sulltani ua besoi administrimin e atyre trevave burrave vendorë, të cilët dalëngadalë shtuan pushtetin e tyre dhe me kalimin e kohës u forcuan aq shumë sa arritën të krijojnë

asilloj sundimi, i cili mund të trashëgohej."

Fjalë si këto të studiuesit të famshëm turk i referohen ndikimit të madh që kishin ato familje shqiptare, të cilat punonin si sanxhakbej (prefekt) të sulltanit (edhe për zemat, timarin dhe dejirin), pra ata që ishin bartës të funksioneve civile dhe militare të pushtetit, si dhe dizdarët, kështjellarët, dhe të tjerë. Mua, ndërkaq, më duket qartë se, në fund të rrëzbitjes së Perandorisë Osmane (1650-1848), tokat shqiptare janë administruar nga vetë shqiptarët.

Po u llogariten në këtë kontekst edhe mijëra shqiptarë tjerë që, në saje të dhuntive dhe të dijes së tyre, punonin me rroga e paga anekënd Perandorisë, mund të paramendohet lehtë, me gjithë ruajtjen e veçorive kombëtare, se adhurimi dhe besimi që mbretëronte në mes të shqiptarëve dhe "sundimtarëve" të tyre, turqve, ishte i madh.


Në kontekst të kësaj ndërvarësie edhe nuk mund të shpjegohet ndryshe ndikimi që kishin turqit sidomos

te shqiptarët muhamedanë. Ndikim ky që është shtrirë në gjithë botën shpirtërore shqiptare, në doket e zakonet e tyre, në administratë dhe armatë, në marrëdhëniet shoqërore dhe rrjedhat ekonomike, pra në gjithë jetën.

Se, përkundër të gjitha këtyre shqiptari mbeti shqiptar është e kuptueshme, por kjo lidhet me faktin habitës se me gjithë afërsinë evidente martesat dhe afria e gjakut ishin shumë të vogla, për të mos thënë të paqena.

Megjithatë, për t'i njohur mirë shqiptarët, nuk mjafton assesi të njihet vetëm e kaluara e tyre para vërshimit së turqve, as edhe studimi i dhjetëvjeçarëve të fundit të sundimit turk mbi ta, por e pakapërcyeshme bëhet njohja e gati pesë shekujve të atij sundimi. E, megjithatë, shkenca e derisotshme ka lënë pas dore studimin e kësaj periudhe.

**Shqipëroi nga gjermanishtja:
Arsim Rexhepi**



Faksimile të dorëshkrimit të Eqrem Bej Vlorës